



Raport Mujor Janar 2026

Informacion bazë

Emri i Fondit	Raiffeisen MIKS
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma minimale e investimit	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	EUR 4,307,550
Cmimi i kuotës	112.9687
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Numri i Investitorëve	119
Kthimi vjetor nga investimi në 31 Janar 2025	+4.91%

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.52% per vitin 2025 ne 31.12.2025
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore të asetëve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parës dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të asetëve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të asetëve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetëz butja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i riskut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit.

Treguesi i riskut dhe përfitimit korresponson me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Struktura e Portofolit të Investimit



Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e aseteve siç janë obligacionet dhe aksionet. Obligacionet janë të investuara 31% në tituj borxhi dhe fonde investimi me kthim të lartë (high-yield), ku 28.4% i përket titujve të Qeverisë Shqiptare, si dhe 30.3% në obligacione dhe fonde investimi me vlerësim të lartë (investment-grade). Pjesa e aksioneve (34.9%) është e investuar në tregje të zhvilluara: SHBA 18.9%; Zona Euro 10.6%, Britani e Madhe 1.8% e aseteve totale. Niveli i cash dhe i likuiditetit është ulur në 3.8% në fund të muajit janar.

Performanca e fondit


Fondi ka shënuar një ecure pozitive mujore prej **0.71%** gjatë muajit janar. Yield-et e obligacioneve qeveritare në Eurozonë ishin pak më të ulëta dhe kërkesa për obligacione të korporatave mbetet e lartë. Një rritje e konsiderueshme në fund të muajit i çoi sërish aksionet në nivele më të larta. Në përgjithësi, fitimet e janarit u udhëhoqën nga indekset me kapitalizim të vogël dhe të mesëm, me Russell 2000 dhe S&P Mid-Cap 400 që tejkaluan indekset e kompanive me kapitalizim të madh. Performanca e tregjeve financiare pati një ndikim pozitiv në portofolin e investimeve të fondit Raiffeisen Miks, i cili shënoi fitime gjatë muajit.

Yield-i mesatar i portofolit të investimeve të fondit është 3.05% për një kohëzgjatje mesatare prej 3.20 vjet më 31 janar. **Kthimi neto vjetor i fondit është +4.91% më 31 janar 2026.**



Ne dt 31 janar 2026	1 Vit	2 Vite	3 Vite	5 Vite	Nga lancimi (16 Dhjetor 2020)
Return in % p.a. for the period	+4.91%	+6.61%	6.80%	2.53%	+2.41%

Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Miks per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varesi të kushteve të tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe të gjithë fondeve të administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudha afatmesme apo afatgjate të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situatat

jo të zakonshme të krijuara perkohesisht në tregjet financiare, sepse në këtë mënyrë nuk do të riskojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjatë muajit Janar

Inflacioni në eurozonë u ul në nivelin 1.7% në janar. Inflacioni bazë, i cili përjashton çmimet më të paqëndrueshme të energjisë, ushqimeve, alkoolit dhe duhanit, rezultoi 2.2% në janar, pak më poshtë se niveli 2.3% i regjistruar në dhjetor.

BQE mbledhet sërish më 5 shkurt dhe pritet të mbajë normën bazë të interesit të pandryshuar, në nivelin 2%. Me të dhënat më të fundit që tregojnë se inflacioni kryesor ka rënë nën objektivin prej 2%, Banka Qendrore ka gjasa të shmangë çdo ulje tjetër të normave të interesit në të ardhmen e afërt.

Çmimet bazë në SHBA u rritën më pak se sa pritej në dhjetor, duke përforcuar shpresat se inflacioni po zbutet. Duke përjashtuar çmimet e paqëndrueshme të ushqimeve dhe energjisë, indeksi i çmimeve të konsumit tregoi një rritje mujore të rregulluar sezonalisht prej 0.2% dhe një rritje vjetore prej 2.6%. Të dyja ishin 0.1 pikë përqindjeje nën pritshmëritë. IÇK totale shënoi një rritje mujore prej 0.3%, duke e çuar normën vjetore të të gjithë artikujve në nivelin 2.7%. Të dyja ishin saktësisht në përputhje me konsensusin e Dow Jones.

Në mbledhjen e saj të janarit 2026, Rezerva Federale vendosi të mbajë normën e fondeve federale në intervalin 3.5%–3.75%. Ky vendim u parashikua gjerësisht nga tregjet financiare, veçanërisht pas tre uljeve radhazi të normave gjatë vitit të kaluar.

Tregjet globale e nisën vitin 2026 në një pozicion më të balancuar krahasuar me vitin e mëparshëm. Inflacioni është moderuar, normat e politikës monetare kanë pësuar rënie nga nivelet maksimale në shumicën e ekonomive kryesore dhe fitimet e korporatave vazhdojnë të tregojnë qëndrueshmëri. Megjithatë, janari u karakterizua nga pasiguri e shtuar, e nxitur nga tensionet gjeopolitike në Amerikën e Jugut dhe Lindjen e Mesme, polemikat rreth tarifave të SHBA dhe shqetësimet mbi pavarësinë e Rezervës Federale, me përfundimin e mandatit të Powell në maj.

Tregjet e obligacioneve mbetën relativisht të qeta përballë trazirave gjeopolitike. Kërcënimi i Presidentit Trump për vendosjen e tarifave në nivelin 25% ndaj aleatëve europianë u tërhoq më pas, por megjithatë shtoi një nivel tjetër pasigurie në perspektivën e rajonit. Rënie u vu re edhe te dollari amerikan, i cili u dobësua kundrejt të gjitha monedhave të tjera të G10 gjatë janarit.

Performanca e tregjeve të obligacioneve qeveritare në vendet e zhvilluara ishte e miksuar. Në SHBA, yield-et e përfunduan muajin më lart, një lëvizje kjo e përqendruar në maturitetet më afagjata. Normat në Eurozonë performuan më mirë se ato në SHBA. Tregu i obligacioneve qeveritare franceze performoi pozitivisht. Spread-et kundrejt Gjermanisë u ngushtuan në nivele të hasura për here të fundit në mesin e vitit 2024.

Tregjet e aksioneve e nisën vitin me një performancë shumë të mirë, të mbështetur nga pritshmëritë për kosto më të ulëta huamarrjeje dhe fitimet solide të korporatave. Megjithatë, luhatshmëria u rrit në momente të caktuara gjatë muajit, përfshirë një rënie të fortë njëditore të shkaktuar nga kërcënimet e reja për tarifa nga Administrata Trump. Aksionet e teknologjisë dhe sektorët e tjerë rritës përjetuan periudha dobësie në mes të muajit, me korrigjime të dukshme në aksionet e kompanive me kapitalizim shumë të lartë. Një rritje e konsiderueshme në fund të muajit i çoi sërish aksionet në nivele më të larta.

Sektori financiar ishte performuesi më i mirë, duke përfituar ndjeshëm nga pritshmëritë se normat më të ulëta të interesit mund të mbështesin kredidhënien. Industria, konsumi i mallrave të luksit dhe materialet, gjithashtu shënuan fitime, të mbështetura nga shenja të qëndrueshmërisë së moderuar ekonomike dhe fitimet e korporatave. Në përgjithësi, fitimet e janarit u udhëhoqën nga indekset me kapitalizim të vogël dhe të mesëm, me Russell 2000 dhe S&P Mid-Cap 400 që tejkaluan indekset e kompanive me kapitalizim të madh.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.